



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e dates 4 qershor 2008, nenit 17 të Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.10 e datës 03 prill 2019, si dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i dates 26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 20. 12. 2019, pas shqyrtimit të propozim vendimit të Kryetarit të Komunës miratoi këtë:

VENDIM

PËR ZËVENDËSIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT VLERËSUES PËR ZBATIMIN E PROCEDURAVE PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË ZK GADIME E ULËT

Neni 1

Përbërja e Komisionit

Me këtë Vendim, zëvendësohen dy anëtarët e Komisionit vlerësues të caktuar sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës 15Nr.463-48439 të datës 19.07.2019 për formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për Vendimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës 15Nr 463-48346 i datës 19.07.2019, ashtu që Shkëlzen Hajdini, Drejtor i Drejtoratit për Ekonomi dhe Zhvillim me numër rendor 1, kryesues i komisionit nga ekzekutivi i Komunës zëvendësohet nga Bekim Shabani Drejtor, nga ekzekutivi i Komunës ndërsa anëtari në numrin rendor 2 Ilir Tasholli, Drejtor i Drejtoratit për Shërbime publike zëvendësohet nga , Nazim Gashi, Drejtor, nga ekzekutivi i komunës, ndërsa me kërkesë të anëtarit me numër rendor 4 , Ramiz Qeriqi, dhe me kërkesë të subjektit politik nga subjekteti politik, zëvendësohet nga Argjend Tasholli

Neni 2

Detyrat dhe Përgjegjësitë

Anëtarët e sapozgjedhur kanë detyrë dhe përgjegjësi të vazhdojnë zhvillimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për Vendimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës 15Nr 463-48346 të datës 19.07.2019 konform dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës.

Nr.15- 020-79228

Lipjan, më 20. 12. 2019

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN



Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi